



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Hydro ing" Sh.P.K. të datës 02.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Hydro ing" Sh.P.K. të datës 02.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Hydro ing" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 02.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës" me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: "Pika 2 Kerkohen dy Eskavator me Zingjir Gome min 13 ton. Te nderuar AK, ne si OE kemi hulumtur dhe kemi ardhur ne perfundim pas shum pyetjeve te bere edhe ne Fabrikat me eminente Botrore per prodhim te Eskavatoreve qe Esakavtor mbi 8 ton me zingjir gome nuk ka ne prodhim. Pasi qe Nga ekspertet e Fabrikave konstatojn qe qdo pesh mbi 8 tone i shkatrron gomat, dhe e vetmja mundesi eshte qe kur jan te nevojshme te mirren Eskavator mbi kete pesh me zingjir te Hekurit dhe mbi ta te Inkurporohe (Vendosen) zingjir Gome si kamoflim. Iu bejem kerkes qe edhe ju si Ak ta keni parasysh kete arsyetim tonin te bazur, dhe ta hiqni si pik komplet apo te dilni me Sqarim qe lejohet edhe me zingjir te Hekurit Apo vetem me Eskavator me Goma Ne duam te besojm qe Ak ka bere vetem Gabim teknik me kete kriter, duke mos hulumtur me tutje. Pasi qe ne te kunderten Konsiderojm shkeljte complete te NENIT 7 TE lpp-se dhe Favorizim i nje anshem nje OE te veteme".

Fillimisht duhet sqaruar se pretendimet ankimore i referohen kërkesës për kapacitetin teknik dhe profesional të formuluar në dosjen e tenderit si në vijim:

Eskavator me zingjir gome min 13 ton (njeri nga eskavatorët të jetë me lopat rrafshuse)

Lidhur me pretendimet ankimore është gjetur se eskavatori 13 ton me zinxhir të gomës nuk është pajisje e domosdoshme pa të cilën nuk mund të realizohet projekti. Përkundrazi, po të largohet kjo pajisje, me pajisjet e mbetura lehtësisht mund të realizohet projekti. Së këndejmi vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 08.04.2025

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.